



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 2472/ 7 prot.

Datë 10.11.2025

**V E N D I M**  
**Nr. 1627/2025**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

|                  |            |
|------------------|------------|
| Fiorent Zguro    | Nënkryetar |
| Anila Malaj      | Anëtar     |
| Kreshnik Ternova | Anëtar     |
| Gjergj Mersini   | Anëtar     |

Në mbledhjen e datës 10.11.2025 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “GP Medical AL” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-45780-04-22-2025, me objekt: “Loti 1: ICD VR”, me fond limit 37,068,500.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 23.05.2025 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare Nene Tereza Tirane

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “O.E.S Distrimed” SHPK në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Biometric Albania” SHPK në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

|                               |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
|-------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Ankimues:</b>              | Operatori ekonomik “GP Medical AL” SHPK me NIPT L82023006C dhe adresë Rruga Nacionale e Vjeter, Godina Nr.41, Vorë                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
| <b>Subjekt i interesuar:</b>  | Operatori ekonomik “O.E.S Distrimed” SHPK me NIPT K31520054N dhe adresë Tiranë, Bulevardi Bajram Curri, pallati "Kastrati"<br><br>Operatori ekonomik “Biometric Albania” SHPK me NIPT J61827062E dhe adresë Bulevardi Zhan D'ark, Pallati 53, Ap 6b, Tiranë                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
| <b>Autoriteti Kontraktor:</b> | Qendra Spitalore Universitare Nene Tereza Tirane me adresë: Rruga e Dibrës Nr. 372, Tiranë                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
| <b>Baza Ligjore:</b>          | Ligji nr. 162/2020 “ <i>Për Prokurimin Publik</i> ” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “ <i>Për miratimin e rregullave të prokurimit publik</i> ”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “ <i>Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.</i> |

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I 1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

## II

### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 23.04.2025, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-45780-04-22-2025, me objekt: “Loti 1: ICD VR”, me fond limit 37,068,500.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 23.05.2025 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare Nene Tereza Tirane.

II.2. Në datë 23.05.2025 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacionit të operatorit ekonomik ankimues dhe raportit të auditit në SPE rezulton, se në datën 27.08.2025, është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, duke i njoftuar me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike për vlerat (pa TVSH) si më poshtë:

|                           |            |      |              |
|---------------------------|------------|------|--------------|
| -“Biometric Albania” SHPK | 32,620,750 | lekë | kualifikuar  |
| -“GP Medical AL” SHPK     | 33,831,000 | lekë | skualifikuar |
| -“O.E.S Distrimed” SHPK   | 37,016,000 | lekë | kualifikuar  |

II.4. Referuar raportit të auditit në SPE rezulton se me 08.09.2025 është publikuar njoftimi i fituesit paraprak të procedurës së mësipërme të prokurimit në sistemin e prokurimit elektronik.

II.5. Me datë 13.09.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimi A/2025/5798, dhe me Nr.2472/2025 Prot., datë 15.09.2025 e operatorit ekonomik “GP Medical AL” SHPK për procedurën e prokurimit, “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-45780-04-22-2025, me objekt: “Loti 1: ICD VR”, me fond limit 37,068,500.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 23.05.2025 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare Nene Tereza Tirane.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “GP Medical AL” SHPK, si edhe me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatorët ekonomikë “O.E.S Distrimed” SHPK dhe “Biometric Albania” SHPK konkretisht duke pretenduar:

## LOT 1

Arsyeja e formularit të vetedeklarimit është e paqene, pasi citimi i neneve 84 LPP dhe 90 RPP kanë lidhje me mbështetjen në kapacitete. Në nuk kemi mbështetjes fare madje kemi deklaruar në formular NUK KEMI në rubriken perkatese. Për rrjedhojë kjo arsye është përmendur pa asnjë bazë faktike vetëm për të skualifikuar operatorin tonë për një arsye të shpikur. Formulari përmbledhës rezultoi i plotësuar saktë.

Lidhur me pikën 2.3.b) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim nga firma prodhuese / MAH / distributori i autorizuar, (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin) për tregtimin e mallrave objekti prokurimi. Autorizimi duhet të jetë origjinal dhe nëse nuk është në gjuhën angleze ose shqipe, të përkthehet në gjuhën angleze ose shqipe dhe të noterizohet,

Në oferte janë sqaruar të gjithë detajet perkatese siç janë kërkuar në DT dhe AK ka patur cdo mundësi të kërkonte shpjegime. Lidhur me pikën 2.3.b autorizimet janë paraqitur nga BIOTRONIK dhe GALT për IRIS shpk dhe BIOTRONIK, të cilat ja kanë dhënë GP MEDICAL AL shpk, GALT dhe BIOTRONIK janë shoqëri që bashëpunojnë me njëra tjetrën. Gjithë lidhja është lehtësisht e dokumentuar dhe rikonfirmohet serish me shkresën e dërguar nga BIOTRONIK për raportin me GALT dhe IRIS për lidhjen e tyre me GP MEDICAL AL shpk, fakti që në kemi dhe dokumentacionin e pajisjeve si CE, kataloge etj tregojnë qartazi se ne jemi të autorizuar ndryshe ku i gjetëm këto dokumenta?! Ka patur dhe një korrespondencë sqaruese me email midis QSUT dhe GALT ku sqarohet lidhja mes GALT, BIOTRONIK, IRIS shpk dhe GP MEDICAL AL shpk. Edhe file CATALOGUE GALT LEADS.pdf tregojnë qartë që BIOTRONIK dhe GALT janë bashkëpunues duke dalë dhe me një katalog si prodhues dhe distributor me status të vecantë lidhja midis tyre duke dalë me një katalog për produktin në fjalë.

KVO nuk ka nxjerrë asnjë arsye teknike apo mos plotësim specifikimesh të pajisjeve mjekësore, por vetëm arsye administrative ligjore të paqena siç argumentuam me sipër.

Lidhur me mosplotësimin e pikës 2.3. d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertën teknike për artikujt e kërkuar, në formë tabele, ku të plotësohet: Specifikimet teknike, Emri i kompanisë prodhuese, Origjina e mallit, Skadenca e mallit, Emertimi i katalogut të artikullit/ produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti, Numri i referencës së artikullit (kodi) nxjerrë nga katalogu i prodhuesit, si dhe çertifikimet perkatese për produktet,

të gjithë të dhënat janë të sakta sipas kërkesës së DT. Skedaret janë të emërtuar me emra perkates lehtësisht të identifikueshëm si CE, ISO, KATALOG etj. për cdo kërkesë të DT dhe në oferte është deklaruar gjithçka është kërkuar sipas pikës 2.3.d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertën teknike për artikujt e kërkuar, në formë tabele, ku të plotësohet: Specifikimet teknike (të paraqitura), Emri i kompanisë prodhuese (BIOTRONIK GALT), Origjina e mallit (USA ose GJERMANI) Skadenca e mallit (sipas kërkesës së DT), Emertimi i katalogut të artikullit/ produktit (SIPAS EMERTIMIT TË KATALOGUT), Nr. e faqes ku ndodhet produkti (cdo faqe, I GJITHË KATALOGU pasi i gjithë katalogu ka specifikimet), Numri i referencës së artikullit (kodi) nxjerrë nga katalogu i prodhuesit (për cdo artikull perkatesisht), si dhe çertifikimet perkatese për produktet (file CE për cdo produkt BIOTRONIK me trupën TUV dhe GALT me trupën SGS lehtësisht të

identifikueshme nga skedaret perkates). Tek file oferta loti 1.pdf eshte cdo informacion i kerkuar. Edhe ne kataloge jane shenuar dhe numrat e artikujve perkates. Nuk kuptojme se perse na ka skualifikuar AK lidhur me kete pike kur informacioni eshte plotesisht aty dhe madje nuk ka cituar asnje arsye teknike per skualifikim, si ka vleresuar AK arsyet specifikimet duke qene se nuk na ka skualifikuar per arsye teknike? AK qartazi i ka pare kataloget dhe certifikimet dhe cdo gje tjeter, pasi ne te kundert do te rezultonim te skualifikuar edhe per pikat 2.1.a;2.1.b; 2.3.c e 2.3.ç qe lidhen me kerkesa te tjera. Por nuk jemi skualifikuar per to, rrjedhimisht fakti qe citohet paraqitja e ofertes teknike nuk lidhet me arsyet e tjera, pasi ne mungese te ofertes teknike dhe dokumentacionit justifikues teknik e ligjor si i ka vleresuar pikat e tjera isot, CE, specifikimet etj?!

AK per cdo paqartesi ka patur mundesine te kerkonte sqarime, por na ka skualifikuar pa te drejte pas me shume se 90 ditesh vleresim ne kundershtrim dhe me ligjin i cili ka afat maksimal 20 ditor. Nuk kuptojme vonesen e AK per vleresim ne kushtet kur nuk ka patur asnje pyetje teknike lidhur me pajisjet tona dhe skualifikimi eshte per arsye ligjore administrative te paqena, per rrjedhoje skualifikimi eshte i padrejte dhe jo ligjor duke diskriminuar operatorin tone.

Kerkojme gjithashtu skualifikimin e operatorit OES DISTRIMED pasi ka shkelur shumatoren e cmimit per njesi ne vleren 794.600 leke sikunder treguar dhe kerkuar ne DT ne tabelen perkatese 2.10 te DT

Blerje materiale mjekësore per Sherbimin e Hemodinamikes - për mbulimin e nevojave 24 mujore:

LOTET: Shumatore çmimi për njësi Lekë pa TVSH Shumatore Çmimi për Njësi

Euro pa TVSH

Loti 1: ICD VR 794 600,00 8 053,92

LOT 2 - MRI IPG FOR PHYSIOLOGICAL PACING/ GJENERATORE PULSI TE

IMLANTUESHMEMRI PER PEJSIM FIZIOLOGJIK 1 433 400,00 14  
528,68

LOTI 3 - BIVENTRICULAR PACEMAKER (CRT-P) 1 474 000,00 14  
940,20

LOTI 4 - PACEMAKER MRI COMPATIBLE/ PACEMAKER TË PËRSHTATSHËMPËR MRI  
298 400,00 3 024,53

LOT 5 MATERIALEMJEKËSORE PËR SËMUNDJET STRUKTURALE 19 163 370,00  
194 236,47

LOT 6 – VASCULAR CLOSURE DEVICE /PAJISJE PER MBYLLJEN E ENEVE TE GJAKUT  
35 000,00 354,75

LOT 7 - BALONA ME PRESION SHUMË TË LARTË PËR ANGIOPLASTIKË KORONARE  
354 978,33 3 598,00

Shumatore të gjitha loteve pa TVSH 23 553 748,33 238 736,55

Ne kemi respektuar kete shumatore cmimesh nderkohe nga oferta e OES DISTRIMED rezulton se nuk plotesohet dot kjo shumatore pas oferta eshte shume e larte krahasuar me tonen qe eshte ne kufij te shumatores se cmimeve per njesi.

Kerkojme edhe skualifikimin e ofertes se operatorit BIOMETRIC pasi nuk ka plotesuar formularin e ofertes sakte duke mos vendosur artikujt dhe cmimet per artikuj sikunder kerkon DT. Artikulli lead introducer i pajsur me shiringen, sonden, agen, sheath etj. kerkohet si peel away sonde ventrikulare ose sheath introducer ne anglisht ne artikullin 3 me sasi 150 cope. Ne artikullin 2 kerkohen edhe 25 cope qe do te shoqerojne pajisjen ICD DR ku ne artikull pershkruhet “me sonden ventrikulare dhe atriale kompatible si dhe me 2 sheath (9 dhe 8 french)”. Pra artikulli 2 ka dhe pajisjen pacemaker ICD DR ka GJITHASHTU dhe setin e introducerit si aksesori me vete shoqerues pasi keshtu eshte kerkuar ne shpjegimin e artikullit. Nderkohe edhe ne artikullin 1 kerkohen 65 cope “bashke me sonden e defibrilimit, introduktore per futjen e sondes se pacemakerit si dhe teknikal support during implantation) Introduktore per futjen e sondes se pacemakerit me punkSION (qe perfshijne guiden, shiringen, dilatorin, agen dhe introduktorin”. Pra ne total jane kerkuar 150 introduktore me vete tek artikulli 1, 25 introduktore shoqerues me permasa 8 dhe 9 french per artikullin 2 ku jane pjese e setit me te gjithe aksesoret perkates, pra kerkohet pajisja kryesore pacemaker plus

vlen e njejta logjike eshte kerkuar edhe ketu ne pershkrim pacemaker plus introduttore. Pra ne total ky lot ka 150 COPE introduttore sipas kerkeses se artikullit 3, 25 COPE sipas artikullit 2 dhe 65 COPE sipas artikullit 1, total 240 introduttore. BIOMETRIC ka ofruar me pak rrjedhimisht edhe oferta e tyre eshte me e ulet pasi nuk ka ofertuar introduttore per cdo artikull sic kerkon qartesisht DT, por vetem per artikullin 3, jemi te sigurt qe per artikujt 1 dhe 2 nuk i ka vendosur ne oferte sic kemi bere dhe ne duke ofruar 240 total dhe jo 150 introduttore LEAD ME AKSESORE PERKATES SI SHIRINGA, AGJA, INTRODUKTORI ETJ. per kete lot. Rrjedhimisht oferta e tyre duhet skualifikuar.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 2472/1 prot., datë 15.09.2025.

II.7. Me shkresën nr. 2472/2 prot., datë 29.09.2025 KPP ju drejtua autoritetit kontraktor mbi detyrimin e tij për dhënie informacioni KPP lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “GP Medical AL” SHPK.

II.8. Përmes shkresës me nr. 2154/5 prot., datë 31.10.2025 me lëndë “Kthim përgjigje mbi ankesat e administruara pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe nëpërmjet sistemit online të ankesave nga Operatori Ekonomik “GP Medical AL” SHPK” protokolluar me tonën me nr. 2472/4 prot., datë 05.11.2025 autoriteti kontraktor ka dërguar në KPP shqyrtimin e ankesës nga ku rezulton, se ky i fundit ka vendosur refuzimin e saj duke argumentuar: “[...]: “[...] **VLERËSIMI I KSHA**

#### **Pretendimet e ankimuesit per lot 1:**

Operatori ekonomik “GP Medical AL” SHPK, në ankesën e paraqitur më datë 13.09.2025, ngre pretendime lidhur me mënyrën e zhvillimit dhe vlerësimit të procedurës së prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF45780-04-22-2025, me objekt “Loti 1: ICD VR”. Sipas palës ankimuese, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka vepruar në mënyrë të padrejtë në skualifikimin e ofertës së operatorit “GP Medical AL” SHPK, duke konstatuar mospërmbushje të kërkesave të DST-së në pikën 2.3 “Kapaciteti Teknik”, konkretisht në gërmat “b” dhe “d”. Ankimuesi pretendon se ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin për përvojën e mëparshme, kontratat e ngjashme dhe personelin teknik, dhe se interpretimi i bërë nga KVO është i pasaktë dhe subjektiv. Po ashtu, pretendon se mungesat e konstatuara në Shtojcën 9 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” janë të natyrës formale dhe nuk përbëjnë shkak thelbësor për skualifikim, në kuptim të nenit 84 të Ligjit për Prokurimin Publik dhe nenit 90 të VKM nr. 285/2021.

Gjithashtu, operatori ekonomik ankimues ngre pretendime mbi mënyrën e kualifikimit të operatorit “O.E.S Distrimed” SHPK, duke deklaruar se ky operator ka shkelur shumatorën e

çmimit për njësi në vlerën 794,600 lekë, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në tabelën përkatëse 2.10 të DST-së. Sipas ankimesit, ky devijim përbën mospërputhje të qartë me specifikimet financiare të dokumenteve të tenderit dhe duhej të çonte në skualifikim automatik të ofertës së këtij operatori.

Në të njëjtën linjë, operatori “GP Medical AL” SHPK ngre pretendime edhe ndaj operatorit “Biometric” SHPK, duke theksuar se ky i fundit nuk ka plotësuar saktë formularin e ofertës, pasi nuk ka vendosur artikujt dhe çmimet për artikujt, sikurse kërkohet në dokumentet e tenderit. Kjo, sipas ankimesit, përbën mospërputhje thelbësore me kërkesat e DST-së dhe ndikon drejtpërdrejt në vlefshmërinë e ofertës së këtij operatori. Në përfundim, operatori ekonomik “GP Medical AL” SHPK kërkon shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e tij, si dhe rishikimin e vendimeve për kualifikimin e operatorëve “O.E.S Distrimed” SHPK dhe “Biometric” SHPK, me qëllim rivlerësimin e ofertave në përputhje me parimet e transparencës, barazisë dhe trajtimit të drejtë të pjesëmarrësve në procedurën e prokurimit.

**Sa më sipër, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vlerëson se pretendimet e palës ankimëse nuk qëndrojnë, për këto arsye ligjore dhe faktike:**

- **Së pari**, lidhur me kapacitetin teknik sipas DST, pika 2.3, germa (d), si dhe kërkesat e neneve 76/3/a dhe 77/1, 4, 5 të LPP, operatori nuk ka paraqitur ofertën teknike në formatin e kërkuar (tabelë me specifikime, prodhues, origjinë, skadencë, referencë/kod nga katalogu dhe certifikimet). Kërkesë kjo e cituar qartazi dhe shënuar mënyra e kërkuar me bold në DST.

Edhe pse në pamje të parë kjo mungesë mund të duket më tepër e karakterit formal, vlerësojmë se standarti i mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është i drejtë. Pasi kjo mungesë është thelbësore, pasi e bën të pamundur verifikimin e përputhshmërisë teknike dhe krahasimin e drejtë me ofertat e tjera, duke cenuar parimet e nenit 3/1 të LPP (barazi, mosdiskriminim, transparencë)

‘1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.’  
si dhe në nenin 92/3 të LPP që lejon vlerësimin vetëm të ofertave në përputhje të plotë me njoftimin e kontratës dhe dokumentet e tenderit.

‘3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.’

Në frymën që legjislatori i ka dhënë LPP-së ndër to dhe dispozitave të mësipërme, mungesa të tilla nuk janë më thjesht formale pasi ndikojnë në barazinë midis pjesëmarrësve në procedurat e

prokurimit publik, dhe nuk mund të korrigojen pa ndryshuar përmbajtjen e ofertës, apo pa çenuar të drejtën e pjesëmarrësve të tjerë.

Ndaj në vlerësimin e KSHA-së, konstatojmë se KVO i është përmbajtur (legi adhaesit) ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, pasi nuk është detyra e KVO-së të grumbulloj informacionin e fragmentuar ndër ‘file’ të ndryshëm që OE ankimes ka ngarkuar në SPE. Detyra e KVO-së është të vlerësoj në përputhje me dokumentet standarte të tenderit dokumentacionin e ngarkuar nga OE pjesëmarrës për të përmbushur kriteret kualifikuese të vendosura nga AK. Pra, është detyrë e OE pjesëmarrës të ofrojnë dokumentacion në formën e kërkuar nga AK prokurues.

**Ndaj në vlerësimin e KSHA-së pretendimi i OE ankimes për këtë pikë nuk qëndron.**

- **Së dyti**, sa i përket Shtojcës 6 (prania e inxhinierit/proktorit për lotet përkatëse) dhe Shtojcës 9 (Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit), operatori nuk e ka deklaruar mbështetjen në kapacitete të një subjekti tjetër, ndonëse nga dokumentacioni rezulton se do të mbështetej te IRIS sh.p.k. Kjo bie ndesh me nenin 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të LPP-së dhe nenin 90/2 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të VKM nr. 285/2021, e cila shprehet:

Neni 84

**Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera**

2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet:

- ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës;
- t'i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme;
- t'i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së;
- në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.

Duke parë dokumentacionin e OE ankimes “GP MEDICAL” sh.p.k vëmë re që në Shtojcën 9 OE ankimes ka dështuar të deklarojë kapacitetet e kërkuara si më sipër.

Për rrjedhojë, kriteret e kualifikimit (aftësia teknike/profesionale) nuk janë përmbushur sipas nenit 77/1/c të LPP-së.

**Ndaj në vlerësimin e KSHA-së pretendimi i OE ankimes për këtë pikë nuk qëndron.**

- **Së treti**, gjatë verifikimit të dokumentacionit të paraqitur nga OE ankimues, KSHA ka vënë re që për autorizimet e prodhuesve dhe garancinë e produkteve (përfshirë ato të GALT MEDICAL), në momentin e depozitimit të ofertës dhe gjatë verifikimit fillestar, dokumentet e paraqitura nuk shtrinin tagra garancie dhe përfaqësimi te operatori ofertues; garancia kufizohej te BIOTRONIK dhe distributori i tij IRIS sh.p.k. Për GALT MEDICAL, vetë prodhuesi konfirmon me email se autorizimi “nuk shtrihet te nën-autorizimet” dhe se IRIS sh.p.k. nuk mund të autorizojë palë të treta pa miratim të posaçëm me shkrim.

Vetëm pas kërkesave për sqarim nga ana e KVO-së në rrugë elektronike, u paraqit një autorizim tjetër i datës 10.07.2025 me formulim të ri ***“This also includes the authorization of any sub-distributors...”***.

Sipas nenit 92/1 të LPP “1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohej, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë **ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.**”

Për pasojë, paraqitja post factum e një autorizimi të ri, që zgjeron tagrat ndaj sub-distributorëve, nuk mund të shërojë mungesat fillestare dhe nuk prodhon efekt kualifikues. Kjo situatë cenon edhe nenin 40/3 të VKM nr. 285/2021, pasi AK ka të drejtë të kërkojë prova të qarta të zinxhirit të autorizimit dhe të garancisë së prodhuesit në momentin e ofertimit.

#### **Ndaj në vlerësimin e KSHA-së pretendimi i OE ankimues për këtë pikë nuk qëndron.**

- **Së katërti**, duke qenë se neni 92/3 i LPP-së parashikon qartë se vetëm ofertat plotësisht në përputhje me kërkesat e njoftimit dhe të DST-së mund të vlerësohen si të vlefshme, dhe duke qenë se neni 82 i RrPP (VKM 285/2021) i jep KVO-s kompetencën të verifikojë ofertat dhe, nëse është e nevojshme, të kërkojë vetëm sqarime pa ndryshuar përmbajtjen, rezulton se oferta e OE ankimues “GP MEDICAL AL” sh.p.k. është e papranueshme për shkaqet e mëposhtme:

- I. mungon oferta teknike në formatin e kërkuar;
- II. nuk është deklaruar mbështetja në kapacitete të palëve të treta sipas Shtojcës 9;
- III. zinxhiri i autorizimeve/garancisë së prodhuesit, në momentin e ofertimit, nuk shtrihet te ofertuesi.

#### **Ndaj në vlerësimin e KSHA-së pretendimi i OE ankimues për këtë pikë nuk qëndron.**

- **Së fundi**, lidhur me pretendimin për “shkelje të shumatores së çmimit për njësi” në vlerën 794.600 lekë në tabelën 2.10 të DT, nga ribërja aritmetike e kryer mbi përbërësit e çmimit (çmimi për njësi × sasia, nën/totalit dhe totali i lotit) nuk rezulton devijim që ta bëjë ofertën e operatorit “O.E.S Distrimed” sh.p.k. të papërgjegjshme. Çdo mospërputhje aritmetike eventuale trajtohet sipas rregullave të DT dhe RrPP (VKM nr. 285/2021), pa ndryshuar çmimet për njësi dhe pa cenuar renditjen, në përputhje me nenin 92/1 të LPP.

*Për më tepër, vlerësimi është zhvilluar sipas ofertës ekonomike më të favorshme (MEAT), bazuar në nenin 87/1 të LPP, me peshët relative të publikuara në DT (neni 87/5). Edhe sikur hipotetikisht të ekzistonte një diferencë e vogël aritmetike (që nuk ekziston), ajo nuk do të ndryshonte rezultatin, pasi metodologjia/peshët mbeten të pandryshuara, ndërsa neni 92/3 lejon vlerësimin vetëm të ofertave në përputhje të plotë me DT.*

**Si rrjedhojë përsa më sipër, KSHA për pretendimin e OE ankimes për shumatoren rrëzohet si i pabazuar.**

.....

*Për këtë arsye, KSHA në respektim të detyrimeve që burojnë nga dispozitat e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 117 si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.*

### **VENDOSI**

- 1. Të refuzoj të plotë ankesën e OE “GP Medical AL” sh.p.k për Lotin 1 me nr.REF-45780-04-22-2025*
- 2. Të refuzoj të plotë ankesën e OE “GP Medical AL” sh.p.k për Lotin 4 me nr.REF-45786-04-22-2025.*
- 3. Kopje e këtij vendimit t’i komunikohet operatorit ekonomik ankues, si dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”*

*II.9. Me datën 31.10.2025 operatori ekonomik “GP Medical AL” SHPK ka ngarkuar në sistemin e ankesave elektronike kundërshtime në lidhje me vendimmarrjen e KSHA të cilat u protokolluan me tonën me nr. 2472/3 prot., datë 31.10.2025 duke u shprehur si vijon:*

*“Ne vijim te vendimit te KSHA per proceduren Nr. REF45780-04-22-2025, me objekt "Loti 1: ICD VR, ju drejtojme keto kundërshtime:*

*Paraqitja ne forme tabelare eshte bere. Vete KSHA e citon formale. Nuk ka asnje mosperbushje specifikimesh apo kerkesash nga ana jone. KVO ka dashur 70 dite per te vleresuar kete procedure dhe nuk ka patur asnje kundërshtim teknik apo dokumentar. KSHA zhvlereson komplet procedurat e prokurimeve kur citon se KVO nuk ka detyre të grumbulloj informacionin e fragmentuar ndër “file” te ndryshëm që OE ankimes ka ngarkuar në SPE. Atehere per cfare hedhim dokumenta provues ne procedure?! Te bejme vetem nje table sic kerkon KSHA. Kjo arsye eshte e turpshme dhe tendencioze kunder shoqerise sone. KVO ne arsyet e skualifikimit nuk ka sqartuar fare por thjesht ka thene nuk ploteson kete kriter.*

*Lidhur me shpikjen e formularit permbledhes dhe deklarimit te mbështetjes ne kapacitet. Nuk kemi mbështetje fare ne kapacitet, por vetem nje pohim te dyfishte nga shoqeria IRIS shpk dhe GP MEDICAL AL shpk per prezencen e proktorit/inxhinierit, pra si nje garanci e dyfishte per*

*AK nga dy shoqerite perkatese. Proktorin e sigurojme te dy shoqerite dhe kete KSHA apo dhe KVO mund te kerkonin sqarim.*

*As ne arsyet e skualifikimit nuk jemi sqaruar fare per kete gje pasi thjesht eshte thene nuk keni plotesuar formularin mbi mbeshitetjen ne kapacitete.*

*Lidhur me autorizimin, shoqeria GALT MEDICAL ne emaillet e saj i ka sqaruar pozicionin e saj duke thene se nukindalohe BIOTRONIK te japi autorizim per tregtim dhe ky qendrim eshte rikonfirmuar disa here nga BIOTRONIK per vete marrdhenien e tyre te vecante qe ka GALT dhe BIOTRONIK pasi ato jane shoqeri te lidhura duke dal edhe me nje katalog. Nuk kuptojme pse KSHA e ka kaq te paqarte dhe pse ka kaq shume mosbesim ndaj nje shoqerie gjermane te BE kur ajo deklaroi se autorizimi vlen per GP MEDICAL AL shpk dhe marrdhenia me GALT eshte e sqaruar. Cfare kerkon me shume KSHA ?! Nuk ka asnje autorizim te dyte qe ndryshon ate qe eshte hedhur ne SPE, GALT ka autorizuar BIOTRONIK dhe IRIS, dhe kane sqaruar se BIOTRONIK ka te drejte te jape autorizime si ta shoh te arsyeshme. Produktet e GALT sigurohen nga BIOTRONIK ku jane sqaruar raportet midis ketyre dy kompanive.*

*Ne jemi oferta me e mire dhe operatori OES DISTRIMED ka shkelur shumatoren e cmimeve per njesi si dhe BIOMETRIC ka gabim ne oferte sic kemi argumentuar ne ankesen filestare duke plotesuar me pak artikuj LEADS nga ato te kerkuara.”*

II.10. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton se nuk janë paraqitur argumente nga subjekte të interesuara në kuptim të nenit 113 të LPP-së në sistemin e ankesave elektronike.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “GP Medical AL” SHPK, për skualifikimin e ofertës së tij me arsyet: “OE nuk përmbush kërkesat e DST në pikën 2.3 Kapaciteti Teknik, në gjermën d)”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “2.3 Kapaciteti Teknik”, pika d të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

**d) Operatori ekonomik** duhet te paraqese **oferten teknike** per artikujt e kërkuar, ne forme tabele, ku te plotesohet: Specifikimet teknike, Emri i kompanise prodhuese, Origjina e mallit, Skadencia e mallit, Emertimi i katalogut te artikullit/ produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti, Numri i references se artikullit (kodi) nxjerre nga katalogu i prodhuesit, si dhe çertifikimet perkatese per produktet.

III.1.2. Nga verifikimi i ofertës së operatorit ekonomik “GP Medical AL” SHPK rezulton se, për plotësimin e kërkesës nga ana e këtij operatori ekonomik në sistemin e prokurimit elektronik nuk është dorëzuar dokument që vërteton plotësimin e kërkesës së mësipërme të autoritetit kontraktor.

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

III.1.4. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2020, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.1.5. Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se:  
1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të

*gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

III.1.6. Në nenin 40, pika 3, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se :

*“3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”*

Në nenin 82 pika 2, paragrafi i parë, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar parashikohet se:

*“2. Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.”*

III.1.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.8. Referuar edhe parashtrimeve në ankesë, ankimesi pranon mungesën e dorëzimit të dokumentacionit të kërkuar në “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “2.3 kapaciteti teknik” pika d në formë tablele pasi arsyeton ngarkimin e tij në SPE në skedarë me emrat përkatës lehtësisht të identifikueshëm konkretisht duke u shprehur se [...]Lidhur me mosplotësimin e pikes 2.3. d)

*Operatori ekonomik duhet te paraqese oferten teknike per artikujt e kërkuar, ne forme tabele, ku te plotesohet: Specifikimet teknike, Emri i kompanise prodhuese, Origjina e mallit, Skadenca e mallit, Emertimi i katalogut te artikullit/ produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti, Numri i references se artikullit (kodi) nxjerre nga katalogu i prodhuesit, si dhe çertifikimet perkatese per produktet, te gjitha te dhenat jane te sakta sipas kerkeses se DT. Skedaret jane te emertuar me emra perkates lehtesisht te identifikushem si CE, ISO, KATALOG etj. per cdo kerkese te DT dhe ne oferte eshte deklaruar gjithcka eshte kerkuar sipas pikes 2.3.d) Operatori ekonomik duhet te paraqese oferten teknike per artikujt e kërkuar, ne forme tabele, ku te plotesohet: Specifikimet teknike (te paraqitura), Emri i kompanise prodhuese (BIOTRONIK GALT), Origjina e mallit (USA ose GJERMANI) Skadenca e mallit (sipas kerkeses se DT), Emertimi i katalogut te artikullit/ produktit (SIPAS EMERTIMIT TE KATALOGUT), Nr. e faqes ku ndodhet produkti (cdo faqe, I GJITHE KATALOGU pasi i gjitha katalogu ka specifikimet), Numri i references se artikullit (kodi) nxjerre nga katalogu i prodhuesit (per cdo artikull perkatesisht), si dhe çertifikimet perkatese per produktet (file CE per cdo produkt BIOTRONIK me trupen TUV dhe GALT me trupen SGS lehtesisht te identifikueshme nga skedaret perkates). Tek file oferta loti 1.pdf eshte cdo informacion i kerkuar. Edhe ne kataloge jane shenuar dhe numrat e artikujve perkates. Nuk kuptojme se perse na ka skualifikuar AK lidhur me kete pike kur informacioni eshte plotesisht aty dhe madje nuk ka cituar asnje arsye teknike per skualifikim, si ka vleresuar AK arsyet specifikimet duke qene se nuk na ka skualifikuar per arsye teknike? AK qartazi i ka pare kataloget dhe certifikimet dhe cdo gje tjeter, pasi ne te kundert do te rezultonim te skualifikuar edhe per pikat 2.1.a;2.1.b; 2.3.c e 2.3.ç qe lidhen me kerkesa te tjera. Por nuk jemi skualifikuar per to, rrjedhimisht fakti qe citohet paraqitja e ofertes teknike nuk lidhet me arsyet e tjera, pasi ne mungese te ofertes teknike dhe dokumentacionit jusifikues teknik e ligjor si i ka vleresuar pikat e tjera isot, CE, specifikimet etj?! [...]”.*

III.1.9. KPP gjykon se mungesa fizike e dokumentacionit të kërkuar shprehimisht në “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “2.3 kapaciteti teknik” pika d, përbën shkak për skualifikim në kuptim të nenit 82 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentat e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Duke marrë shkas nga pretendimet e ankimuesit se “Tek file oferta loti 1.pdf eshte cdo informacion i kerkuar” KPP nga verifikimi i dosje (file) të sipërcituar nga vetë ankimuesi vëren se kemi të bëjmë me shtojcën 3 “Lista e çmimeve të artikujve”, formati i së cilës si pjesë e DST është i miratuar nga organi kompetent i caktuar me ligj, Agjencia e Prokurimit Publik dhe nuk mund të ndryshohet nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës. Nga shqyrtimi i këtij dokumenti (shtojca 3 “Lista e çmimeve të artikujve”), KPP arrinë në konkluzionin se përveçse formati i shtojcës është modifikuar nga ankimuesi duke shtuar informacion që lidhet me plotësimin e pikës d të kapacitetit teknik në kriteret e vecanta të

kualifikimit, ai nuk përlligj dokumentin e kërkuar në mënyrë eksplicite në këtë kriter, ofertën teknike në formë tabele me informacionet përkatëse. Akoma më tej KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Gjithashtu, Komisioni sqaron se nëse operatorët ekonomikë do të kishin pretendime në lidhje me kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit kanë patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës lidhur me kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit, parashikuar nga neni 110 pika 1 e ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar në të cilin parashikohet se “1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.” Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në gjashtë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga pika 1 e nenit 75 të LPP-së ku përcaktohet se “1. Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave.

Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit.

Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit [...]

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me arsyen e skualifikimit të ankimuesit “GP Medical AL” SHPK “OE nuk ka plotësuar të gjithë seksionet e Shtojcës 9 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” në mbështetje të Nenit 84 të LPP-së dhe Nenit 90 të V KM Nr.285.”, KPP vëren se ,

III.2.1. Në pikën 2.16 të dokumenteve të tenderit autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë:

**2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:**

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilën ofertuesi ndalohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Po

X

Jo



**Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që ndalohet mbështetja:**

- Shtojca 8, Kriteret e Veçanta, 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar, germa a)
- Shtojca 8, Kriteret e Veçanta, 2.3 Kapaciteti teknik, germa a)
- 

III.2.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

III.2.3. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2020, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.2.4. Në nenin 77, pikat 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.2.5. Në nenin 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet:

1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta.

2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t’i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë.

3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. Autoriteti ose enti kontraktor duhet t’i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit.

5. Nëse operatori ekonomik shfrytëzon aftësi nga subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e marrëveshjes.

6. Ndërkohë, në rastin kur operatorët ekonomikë mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojë oferta ose të paraqitet si një kandidat i vetëm.

7. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që detyra/punë/aspekte kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjëri prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ofertues.”

III.2.6. Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 3 e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i

ndryshuar, parashikohet se: “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.2.7. Në nenin 45 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese” pika 6, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“6. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen, për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Në rast dyshimi, autoriteti/enti kontraktor verifikon saktësinë e informacionit dhe provat e paraqitura nga ofertuesit.”.

III.2.8.Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.KPP-ja gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

III.2.9. Në rastin konkret, referuar arsyes së skualifikimit të autoritetit kontraktor, si fillim KPP konstaton se ajo është e paqartë pasi nuk ka specifikuar se cilën prej aftësive teknike apo profesionale për përmbushjen e të cilave lejohet mbështetja në kapacitete e subjekteve të tjera, ankimuesi nuk e ka deklaruar në seksionet përkatëse të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit por është mjaftuar me citimin e dispozitave ligjore të *lex specialis* që regullojnë këtë pozitë. KPP i sjell në vëmendje autoritetit kontraktor se ashtu sikurse është barrë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, të vërtetojë se disponon kapacitetet tekniko-ligjore në lidhje me përmbushjen e kriterëve për kualifikim si dhe të specifikimeve teknike të kërkuara, edhe autoriteti kontraktor (Komisioni i Vlerësimit të Ofertave) ka barrën e provës të vërtetojë dhe argumentojë, se cilin nga kriteret apo specifikimet teknike nuk plotëson operatori ekonomik duke mirëargumentuar edhe mosplotësimin e tyre. Bazuar edhe në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, barra e provës në rastin konkret për vërtetueshmërinë e pretendimit (arsyes së skualifikimit), i takonte Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të identifikonte në mënyrë të saktë dhe të qartë, duke dhënë argumentet mbi këtë fakt, i cili në rastin konkret ka dështuar t’i evidentojë dhe t’i argumentojë. Gjithashtu duke ju referuar dispozitave të cituar nga autoriteti kontraktor në arsyen e skualifikimit ( *Nenit 84 të LPP-së dhe Nenit 90 të VKM Nr.285*) bëhet fjalë mbi mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera dhe nga shqyrtimi i materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ nuk rezulton që ankimuesi të jetë mbështetur në kapacitetin e subjekteve të tjera për përmbushjen e kërkesave teknike dhe profesionale për sa lejohen nga vetë autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Në pikën 3 të nenit 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar përcaktohen se: “3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.” Komisioni gjykon se duke e konsideruar mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera kur kjo gjykohet e nevojshme nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi si një kusht të rëndësishëm për plotësimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale si dhe për vetë ecurinë e kontratës, në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik është përcaktuar qartë që operatori ekonomik i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim dhe më pas kjo të deklarohet edhe në seksionet përkatëse të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit. Në këto kushte KPP gjykon se për sa kohë në kuptim të parashikimeve të nenin 84 pika 3 të *lex specialis* nuk kemi të paraqitur një angazhim me shkrim të subjekteve mbi të cilët do të mbështetëj ankimuesi për plotësimin e aftësive teknike dhe profesionale (autorizimi i “Iris” SHPK i datës 14.05.2025 që deklaroi se do të siguroj praninë e inxhinierit për lotet 1 dhe 4 nuk përbën një dokument të tillë) nuk gjendemi para rregullimit të përcaktuar nga neni 84 i LPP-së dhe neni 90 i VKM Nr.285 “Për miratimin e rregullave për prokurimin publik” i ndryshuar dhe si rrjedhojë ankimuesi nuk kishte detyrimin për plotësimin e seksioneve përkatës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit për këtë rast.

Sa më lart pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik “GP Medical AL” SHPK për skualifikimin e tij nga ana e autoritetit kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron, dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të KPP do të mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike dhe faktike të këtij operatori ekonomik, e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.4. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “GP Medical AL” SHPK mbi kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Biometric Albania” SHPK dhe “O.E.S Distrimed” SHPK në këtë procedurë prokurimi, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se,

III.4.1. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

*“2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.*

*Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.*

*7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.*

*8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”.*

III.4.2. Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.

III.4.3. Në nenin 94 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet:

*1. Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi sipas LPP, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.*

III.4.4. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të paraqesë (argumentojë), se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP është i papranueshëm.

Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik, me synim vendosjen në pah të ratio legis, mbështetur edhe në parimin e së drejtës se ratio legis est anima legis, (qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit), interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet të jetë dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik. Neni 94, pika 1, kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Referuar ligjit dhe rregullave të prokurimit publik, duhet të plotësohen dy kushte kumulative: (legjitimimi *locus standi*), interesi i ligjshëm për të marrë një kontratë, ose dëmtimi apo rreziku për t'u dëmtuar nga një shkelje e pretenduar.

III.4.5. I vetmi interes i ligjshëm, që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhënë në kuadrin e një procedure prokurimi është që përmes ankimit, ai të fitojë kontratën. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën, se pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës.

Rrjedhimisht, në këtë rast operatori ekonomik “GP Medical AL” SHPK do të vijojë të mbetet i skualifikuar pas arsyetimit më sipër të KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real (*përkundrejt atij imagjinar*), nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në këtë procedurë prokurimi.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos:**

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “GP Medical AL” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-45780-04-22-2025, me objekt: “Loti 1: ICD VR”, me fond limit 37,068,500.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 23.05.2025 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare Nene Tereza Tirane.
2. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “GP Medical AL” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “GP Medical AL” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

|                         |                    |                       |
|-------------------------|--------------------|-----------------------|
| <b>Anëtar</b>           | <b>Anëtar</b>      | <b>Anëtar</b>         |
| <b>Kreshnik Ternova</b> | <b>Anila Malaj</b> | <b>Gjergj Mersini</b> |

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

